



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1536 Prot
Nr. 2327 Dosje

Tiranë, më 23.11.2022

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë, Alda Kodra, me detyrën e Përmbarruese Gjyqësore Private, pranë Zyrës së Përmbarrimit Privat "TDR GROUP" sh.p.k. në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.18216, të lëshuar me datë 03.11.2022 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarrimore Nr.2327, Datë 22.11.2022, kërkesën e kreditorit Shoqëria "EUROPETROL DURES ALBANIA" sh.a, ndaj debitorit shoqëria "SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE" Sh.a me NIPT J91329003O, në lidhje me Titullin Ekzekutiv "Faturë Tatimore Shitje Nr.T10, datë 05.01.2016, me Nr. serie 27701676".

Pasi mora Vendimin Nr.1534 Prot, datë 23.11.2022 për fillimin e menjehershëm të ekzekutimit të detyrueshëm, sipas kërkesës së kreditorit, referuar nenit 519 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se ndaj debitorit, shoqëria "SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE" Sh.a me NIPT J91329003O, duhen kryer në mënyrë të menjehershme të gjitha veprimet procedurale, të cilat bëjnë të mundur ekzekutimin e detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të fillojë ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi asetet e debitorit shoqëria "SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE" Sh.a me NIPT J91329003O, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Për sa më sipër, në referim të Ligjit 26/2019 "Për Sherbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:
➤ Shoqëria "SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE" Sh.a, me NIPT J91329003O
2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
 - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
 - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
 - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Personat që behen pengese, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobes dhe kallzimit penal.
5. Kjo kërkesë përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

ZYRA E PËRMARRIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.
PËRMARRUES GJYQËSORË
ALDA KODRA



Zyra e Përmbarrimit Privat "TDR Group" Sh.p.k.
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kati i I-të, Nr. 54, Tiranë
Tel: 00355 42 427790
www.tdr.al

